



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI-të

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritime Evropiane

Mbledhja nr. 12.

Prishtinë, më 02.02.2018 në ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1.

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku, Fitore Pacolli dhe Adem Hoxha.

Mungoj: Glauk Konjufca

E ftuar: Dhurata Hoxha – Ministre për Integritime Evropiane .

Nga Staffi Mbështetës i Komisionit:, Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerr: Përfaqësuesi nga GLPS, GIZ, OSBE-së, NDI, KDI, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi znj. Blerta Deliu Kodra – kryetare e Komisionit.

Kryetarja-Blerta Deliu Kodra pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e Komisionit me këtë;

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim lidhur me Strategjinë e Zgjerimit të Bashkimit Evropian për Shtete e Ballkanit Perëndimor, e ftuar znj. Dhurata Hoxha - Ministre e Integritimit Evropian;
3. Te ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës;

1. Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

Kryetarja e falënderoj ministren për përgjigjeje te shpejtë në ftesën e komisionit si dhe për gatishmërinë për të diskutuar lidhur me çështjet aktuale sa i përket procesit të integritimit.

Në vazhdim tha se tashmë pritet shumë shpejtë që Bashkimi Evropian të dal me Strategjinë për zgjerim për vendet e Ballkanit perëndimor.

Në kuadër të këtyre zhvillimeve të fundit ka pasur shumë deklarata dhe opinione të ndryshme lidhur me përfshirjen ose jo të Kosovës në këtë Strategji.

Andaj duke pas parasysh ndikimin e kësaj Strategjie në politiken integruese të Kosovës në Bashkimin Evropian, ne ju kemi ftuar sot që të diskutojmë nëse Kosova do të jetë pjesë e kësaj Strategjie, se cilat hapa janë ndërmarr nga ana e institucioneve tonë në përfshirjen e Kosovës në këtë Strategji dhe cilat janë arsyet që po ndikojnë në zvarritjen e procesit integrues të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Po ashtu, dëshirojmë të dimë se cilat janë sfidat me të cilat po ballafaqoheni ju si Ministri si dhe hapat e ardhshëm që ju si Ministri planifikoni t'i ndërmerri me qëllim të avancimit të agjendës evropiane.

Dhurata Hoxha – Ministre e Integritimeve Evropiane, falënderoj për ftesën dhe mendoj se është kohë e qëlluar për raportim sepse me 6 shkurt do te publikohet strategjia,ajo theksoi se Strategjia për Ballkanin Perëndimor e Komisionit Evropian është paralajmëruar në kuadër të “Deklaratës së Synimeve” që është promovuar pas paraqitjes të Presidentit të Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker në fjalimin vjetor para Parlamentit Evropian në shtator 2017. Asnjërit nga vendet tjera të rajonit, nuk i është prezantuar formalisht ndonjë draft i kësaj strategjie, prandaj është e parakohshme që të komentohet përmbajtja e saj deri në publikimin e saj javën e ardhshme. Gjithashtu edhe para qarkullimit te drafteve joformale me publikimin e letrës së synimeve, ne takimet e mija që kam pas ne Bruksel dhe vendet tjera kamë kërkuar që Kosova te përfshihet me një gjuhë te saktësuar dhe konkrete dhe perspektivë te qartë.

Rruga drejtë anëtarësimit është individuale dhe ndërtohet ne bazë te meritave dhe punës që e bënë ,por ne anën tjetër kemi kërkuar që Kosova te përfshihet ne mënyrë sa më konkrete dhe koncize në Strategjinë e zgjerimit, sepse asnjë strategji nuk do te jetë e plotë pa përfshirjen e Kosovës ne te ardhmen e BE-së Në kuadër te shkëmbimeve të rregullta që kemi me institucionet e BE-se dhe vendet anëtare, i kemi prezantuar qëndrimet tona. Në këtë drejtim më lejoni të japë disa nga këto qëndrime. Procesi integrues i Kosovës ka pasur një avancim progresiv viteve të fundit, kemi siguruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit,jemi në prag të liberalizimit të vizave, kemi siguruar qasje në Programet e BE-së dhe jemi përfitues më të mëdhenj për kokë banori të asistencës së BE-së. Në vazhdim tha se presin që Strategjia ta njoh progresin e arritur dhe të konfirmoj avancimin e procesit integrues të Kosovës në Bashkimin Evropian. Jemi plotësisht te vetëdijshëm për kufizimet objektive, respektivisht ne mosnjohjen e 5 vendeve anëtare , por njëkohësisht jemi te bindur që nëse sigurojmë zbatimin rigoroz te MSA-së ,BE do te gjej mënyra për të avancuar procesin integrues.

Sa i përket informacioneve që ne i kemi pranuar qoftë përmes kanaleve zyrtare dhe komunikimeve publike te BE-së, na është thënë që strategjia do te ofroj një perspektivë evropiane për gjithë Ballkanin perëndimor dhe do ti kushtohet një rëndësi e veçantë të çdo tejkallim bilateral ne mënyrë që te sigurohen që vendet e Ballkanit perëndimor mos te krijojnë probleme gjatë procesit. Ne vazhdim kanë mbetur hapa te fundit drejtë finalizimit te Strategjisë dhe me informacione që kemi shefet e kabineteve te Komisionerëve ne Bruksel do ta shqyrtojnë përmbajtjen e Strategjisë dhe përfundimisht

do te miratohet ne kolegjin e komisionarëve ne Strasburg te martën dhe te prezantohet ne parlament Evropian.

Dua ti them vetëm dy gjëra që lidhen ne mënyrë indirekte me strategjinë, liberalizimi i vizave është prioritet që shkon përtej Strategjisë. Disa nga çështjet që priten të arrihen rezultate të prekshme janë në fushën e gjyqësorit, rritjen ekonomike dhe arsim më të mirë, si detyra që duhet edhe të argumentohen. Nuk duhet harruar që prioriteti i parë i institucioneve tona duhet të jetë zbatimi i reformave të gjithmbarshme të parapara me MSA-në. Vetëm rezultatet e bindshme dhe progresi në kuadër të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë do të vendos institucionet tona me një pozitë ku mund të kërkojmë më shumë nga ana e BE-së. Për momentin, topi është në anën tonë që t'i përfundojmë detyrat e shtëpisë. Ajo propozoj një Rezolutë edhe për Qeverinë edhe për Kuvendin dhe te rikonfirmojnë konsensusin nacional te të gjitha institucioneve dhe tërë klasës politike sa i përket integritet evropian dhe te gjejnë një gjuhë te përbashkët qe te hecim përpara dhe ta zëmë hapin sepse viti 2018 është një vit shumë i rëndësishëm sa i përket procesit te integritit.

Kryetarja, theksoi se jemi te vetëdijshëm si anëtar te komisionit se nuk mund ta diskutojmë projektin e zgjerimit pa qenë i definuar, meqë i ka pas deklarata te shumta një pjesë e jona kemi arritur te sigurojmë draftin që ka qarkulluar ditëve te fundit. Natyrisht që ne draftë është kërkuar që te ketë qartësi më shumë nga ju, a keni informata nëse do te përmendet aplikimi ne ketë drafte strategji që nuk është finalizuar ende, po ashtu edhe një rëndësi e veçantë i është kushtuar implementimit te MSA-së dhe ERE-së dhe dialogut me Serbinë duke e potencuar progresin që duhet ta shënojë republika e Kosovës në këtë drejtim. Keni përmendur ne njërin prej deklaratave te juaj vitin 2018 si vit i liberalizimit te vizave, ne si anëtar te komisionit pas publikimit te dokumentit final te strategjisë së Ballkanit perëndimor, jemi te interesuar ta shohim rolin tonë që te angazhohemi me tepër për te shënuar ndonjë progres. Cili është pozicioni i Kosovës ndaj shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën a do te ketë barrikadim te serishëm ne raport me anëtarësimin e Kosovës ne organizatat e ndryshme rajonale

Ilir Deda, tha se ky takim ka te bëjë me diskutim te hapur me ministren e jo çështje e pyetjeve dhe përgjigjeve .

Kryetarja, tha se deputetët mund te bëjnë dhe kanë pyetje për ministren që kontribuojnë ne te mirë te këtij procesi

Fitore Pacolli, tha, e dimë se informatat për strategjinë që do te publikohet nuk janë te vërtetuara, ju si ministre a keni kontaktuar me zyrtaret e Brukselit për të kërkuar më shumë informata lidhur me te dhënat që do ti kontribuojnë strategjisë sa i përket Kosovës dhe sa herë e keni vizituar Brukselin për te biseduar për këtë çështje, nëse keni pas takime me kënd keni pas dhe sa takime keni pas deri më tani dhe çfarë konkretisht keni kërkuar ne këto takime.

Ne draftet që kanë qarkulluar e dimë se Serbisë i është dhënë një datë se përafërsisht kur mund te anëtarësohen, kurse për Kosovën nuk është përmendur fare asnjë datë, për deri sa ne emër te integritet evropian janë shtyre shumë diskutime dhe në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë deri më tani Kosova ka dhënë shumë dhe ka pranuar koncesione te dëmshme ne emër te këtij integriti, tash po shohim se Serbia ka përparuar mjaftë shumë ne rrugën e saj ne integritet evropiane dhe ne si Kosovë kemi mbetur mbrapa pa realizuar shumë reforma te rëndësishme te zhvillimit ekonomik.

Ahmet Isufi, përshëndeti iniciativën për një Rezolutë me konsensus ne Parlamentin e Kosovës, ne mënyrë që te kërkojmë te bëhet një integrim më i shpejt ne te gjitha mekanizmat e BE-së dhe njëkohësisht te theksojmë gatishmërinë tonë për te plotësuar te gjitha kriteret ne mënyrë që Kosova mos te mbetet prapa dhe njëkohësisht te bëjmë vlerësimin tonë edhe rreth angazhimit te shteteve. Kosova ka treguar ne vazhdimësi një angazhim konstruktiv, ndërsa rezultatet janë negative sa i përket raportit mes Serbisë dhe Kosovës ne këto integrime.

Bashkësia ndërkombëtare ka investuar ne Kosovë dhe nuk është mirë që Kosova te jetë e dëmtuar ne këto procese. Edhe ne raport kemi te bëjmë me ndihmat që japin BE , pastaj dhe me asistencë përmes grandeve por qe, ne nuk kemi iniciativa për investime ne zhvillim ekonomik gjë cilën ka fituar Serbia dhe ne këtë rast nga bisedimet më shumë kanë favorizuar Serbinë që ka qenë gjithmonë destruktive se sa Kosovën që i është përgjigj çdo agjende te BE-së. Dua te theksoj se Kosova duhet ti jap fund epilogut duke mos pas agjendë te veten dhe një platformë te veten që do te mundësonte avancimin e Kosovës.

Milaim Zeka, theksoi se mund te mos pajtoheni që me fajin e Parlamentit dhe klasës politike ne e kemi kthyer Kosovën ne vitet 2000. Ne vitin 2000 BE e ka pas vetëm një temë ne klasën politike te Kosovës ,ndalimin e Serbëve dhe mos shpërnguljen e tyre nga Kosova. Tani jemi kthye ne dy tema ,tema e demarkacionit dhe tema e gjykatës speciale, që për turpin ma te madh është bërë temë dhe ata që kanë vetëm pak rezon politik e kanë dit qe gjykata speciale nuk mund te ndryshohet, ne dëgjuam deklaratat e fundit te presidentit dhe zyrtarëve tjerë që nuk ka hajgare me punën e gjykatës speciale. Lidhur me atë që u tha se Kosova është mënjanu nga ana e Brukselit dhe Parlamentit Evropian, për këtë mënjanim e kemi fajin ne deputetët dhe klasa politike e Kosovës, si Qeveritë e kaluara edhe Qeveria aktuale, sepse delegacionet e Serbisë dhe Malit te Zi kur te shkojnë ne Strasburg nuk ndodh me e shah vendin e vet, kurse ne shkojmë atje me shah vendi tonë, ne shkojmë atje pa asnjë gjuhë te përbashkët politike dhe mos dakordimi jonë dhe mos vetëdija jonë politike për tema te përbashkëta që janë interes nacional për te cilat ne duhet me shku dhe me gjet një gjuhë te përbashkët po na dëmton shumë.

Sa i përket çështjes së Rezolutës te propozuar,tha se është e shumë e qëlluar por është e vonuar sepse delegacioni i Kosovës që e vizitoj Strasburgun para disa ditëve, një pjesë e ka shkaktuar një defekt aq te madh politik, sa qe me vite te tëra duhemi me riparua konfrontimin e këtij delegacioni me zyrtarët evropian dhe besoj që edhe ju ministre do te na jepni një sqarim se cili është faji i delegacionit te Kosovës se pse nuk është miratuar Rezoluta ne parlamentin Evropian,ku deputetët e parlamentit Evropian kërkuan që ne ta respektojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Gjykatën speciale e cila është ne fuqi, kurse këta e kundërshtuan dhe nuk u miratua Rezoluta, dhe për këtë askush nuk shkon ne përgjegjësi penale dhe morale sepse po e kthejnë Kosovën te viti 2000 në aspektin politik dhe po e shkatërrojnë miqësinë për te cilën ne kemi luftuar 2000 vjet me u bashku me perëndimin Ne fund tha se për të gjitha problemet nuk është fajtoare Evropa,por fajtor janë deputetët dhe politika e keq udhëhequr.

Ministrja, tha se do te mundohem pak ne mënyrë sa me te përgjithësuar te ju përgjigjem. Drafti momental i Strategjisë është jo zyrtar dhe është ne plotësim e sipër deri ne draftin final i cili nuk jep afate kohore as për Serbin dhe as Malin e zi dhe disa nga elementet kryesore që janë te përfshira ne këtë draft është specifikuar se te gjitha

vendet e Ballkanit perëndimor do të anëtarësohen në BE, por jo në situatën në të cilën ndodhen tani jo pa i bërë reformat e duhura dhe pa i kryer detyrat e shtëpisë., në mënyrë me specifike kërkohet të avancohet edhe në konkureshmërinë ekonomike duke specifikuar se hyrja në BE është zgjedhje e secilit vend e jo imponim, kërkohet të ketë zotim politik për orientim evropian për të cilin zotim konsideroj se duhet të jetë gjithëpërfshirës, në mënyrë të përgjithshme për të gjitha vendet është se vëmendje e veçantë duhet kushtuar sundimit të ligjit ku kërkohen reformat në sistemin e drejtësisë, luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, por në mënyrë specifike ku është përmendur Kosova, i kërkohet bashkëpunimi i plotë me Gjykatën speciale dhe kërkohet të zgjidhen probleme mes shteteve dhe shprehimisht kërkohet që Kosova dhe Serbia të kenë një marrëveshje përfundimtare për të avancuar me procesin e integritetit .

Kurse lidhur me komentet që u bënë lidhur me dialogun, qëndrimi i Republikës së Kosovës është që dialogu pritet të rifillojë, tani në mënyrë më të strukturuar dhe transparente dhe më i avancuar dhe në mënyrë të çart duhet të ketë një datë të përfundimit në mënyrë që mos të zgjatet në pafundësi dhe qartë të saktësohet qëllimi kryesor , i cili duhet të jetë njohja reciproke dhe të dyja shtetet të vendosin marrëdhënie të mira fqinjësore dhe kërkohet që kjo marrëveshje që do nënshkruhet duhet të ketë fuqi obligative dhe kjo gjuhë është përmendur edhe në strategji që të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor do të kenë para anëtarësimit një marrëveshje e cila do të ishte obligative për shtetet e Ballkanit perëndimor në mënyrë që asnjëra mos ta pengoj tjetrën për të hyrë në BE, viti 2018 duhet të jetë viti i liberalizimit të vizave sepse për herë të parë flet me një gjuhë të qartësuar lidhur me perspektivën e Ballkanit perëndimor dhe nëse arrijmë në që gjatë këtij viti të përmbushim detyrat e shtëpisë atëherë i mbetet edhe BE-së që të përmbushin pjesën e marrëveshjes për liberalizimin e vizave.

Po ndërlihem me pyetjen për vizitat e mija në Bruksel, kam pasur vizita dhe takime të shumta me zyrtarët e BE-së dhe zyrtarë tjerë dhe homolog të mi në vendet partnere dhe vendet që e përkrahin Kosovën në çdo hap, është kërkuar që Kosova të i kryej obligimet e saja dhe posaçërisht çështja e demarkacionit të ketë një epilog të shpejt.

Sfidë gjithmonë mbetet mosnjohja nga 5 vendet e BE-së dhe posaçërisht situata tani e rikrijuar në Spanjë nuk na ndihmon, përkundër faktit që MSA është një marrëveshje e parë kontraktuale me BE-në dhe nëse Qeveria dhe Komisioni për integritet evropian duhet të kemi intensifikim të lobimit dhe kontaktit jo vetëm me 5 vendet që nuk na kanë njohur por edhe me të gjitha vendet tjera të cilat në një mënyrë apo tjetrën mund të risin ndikimin që ta zbusin qëndrimin e posaçërisht të Spanjës.

Në vazhdim tha se arsyeja pse e propozova rezolutën për të cilën kam diskutuar edhe me Kryeparlamentarin dhe Kryeministrin, është sepse neve na duhet një konsensus nacional dhe rikonfirmim për rrugën tonë integruese, jemi duke e hartuar edhe një strategji të lobimit apo ndërtimit të marrëdhënieve me secilin prej anëtarëve të BE-së dhe kjo strategji do të jetë gjithëpërfshirëse ku do të përfshihet edhe komuniteti i biznesit dhe me kontaktet e secilit prej nesh do të arrijmë që ta avancojmë në shumë segmente.

Ilir Deda, tha se më vije keq që nuk jemi duke i informuar qytetarët për pasojat nëse ajo strategji e cila në fund duhet të aprovohet nga Këshilli i BE-së në qershor nuk do të ketë një datë orientuese edhe për vendet tjera të Ballkanit perëndimor, kjo do të thotë që njerëzit tonë duhet ta kuptojnë që ne mund të ëndërrojmë që mund të bëhemi pjesë e BE-së është viti 2030 ,tash ky proces ka hy në pjesë më konkrete dhe nuk është që dikush për Kosovë ka ekskluzivitet në informacione sepse të ne ekziston konsensusi

nacional deklarativ politik qe te bëhemi pjesë e BE-së,edhe rezoluta e juaj e propozuar është deklarative dhe Kosovës nuk i duhet më një politik deklarative .

Ju disa herë e keni përmendur se Kosova duhet te aplikoj për status kandidati ne vitin 2018 dhe këtë nuk mund ta bëni vetëm si ministri dhe Qeveri por at konsensus deklarativishtë që ekziston duhet ta shtimë ne funksion te lobimit pasi te kaloj demarkacioni. Duhet te flisni me data dhe te thuani se kur është momenti i fundit që duhet te kaloj demarkacioni që ne mund te kemi vendim pozitiv për viza. Avancimi që i përket këtij procesi me Serbinë ne këtë draft strategji është që për herë te par quhet marrëveshje gjithëpërfshirëse e obliguar ligjore e Kosovës dhe Serbisë dhe kjo është pozitive per ne, nuk mund ta ndërroj Kosovën vetëm procesin e integritimit nëse nuk ka përkushtim, ju si ministre keni përkushtim por nuk është e mjaftueshme sepse ju keni problem me reformën ne administratën publike, me kontratat mbi vepër ne nivel qendror dhe nepotizëm.

Te gjithë ne që jemi te informuar e dimë që sa i përket Ballkanit perëndimor e për ne është e rëndësishme Kosova, vetëm fundi i vitit 2018 mund te na ndihmoj për shkak te klimës pozitive që ekziston ne komision. Duhet te diskutojmë se nëse kalon demarkacioni ne shkurt, komisioni ynë dhe ministria duhet ta bëjnë një plan pune i përbashkët dhe se bashku ta formojmë një grup punues i cili do ta bënë kalendarin e punëve te përbashkëta për vitin 2018.

Zenun Pajaziti, theksoi se këto zhvillime te fundit janë shqetësuese për te gjithë, por edhe ky dokumenti i fundit për zgjerim me siguri ju ka alarmuar edhe juve ministre si përgjegjëse ne Qeverinë e Kosovës si dhe të gjithë deputetët e parlamentit. Ne vetëm mund te ngutemi deri sa nuk e pranojmë versionin zyrtar te strategjisë,nëse ne flasim e mundohemi me bërë diçka që kish me mundur me u ndryshua ne ndërkohë këtë dokument dhe krejt qasjen edhe ne BE dhe proceset tona ne BE do te ishte mirë,por ka pengesa dhe këto duhet adresuar, nuk mendoj se e ka mundësin vetëm një ministër as vetëm qeveria por duhet adresuar pengesat brenda qeveris,institucioneve dhe gjithandej dhe ka probleme që nuk lidhen vetëm me ato kriteret teknike por ka probleme që duhet sa më shpejt me i zgjedh. Mendoj se puna e strategjisë lidhet me krejt këto zhvillime tona te brendshme dhe secili prej nesh kemi përgjegjësi dhe duhet të i adresojmë sa më shpejt. Jam ithtar i rezolutes së përbashkët por mendoj se nuk është problemi te një zotim formal siç u adresua këtu për rrugën tonë drejt BE-së sepse nuk ka askush qëndrime tjera sa i përket rrugës tonë por kemi problem serioz per me i adresua hapat dhe me e koordinua këtë proces.

Sa i përket liberalizimit te vizave duhet me i dhënë sa më shpejt fund kësaj pune sepse jemi vonuar për qytetarët tanë,te gjithë e dimë se demarkacioni është kusht dhe ky është një problem serioz.Kurse lidhur me Gjykatën speciale tha se është mirë qe lideret politik te institucioneve që dolën pas Kryetarit te Kuvendit dhe kjo është për tu falënderuar sepse kjo ka qen një prej sfidave tona dhe tani është një moment i mirë që qeveria ne agjendën e saj me i dinamizua krejt kë to çka duhet dhe ka kaluar koha që me qenë shumë te përgjithësua detyrat dhe ngecjet e institucioneve sepse duhet me u dit se cila hallkë ka probleme ne këtë drejtim dhe me u zgjidh .

Armend Zemaj, theksoj se nuk është takimi i parë që Komisioni për Integritet Evropiane po krijon një mundësi që pjesa integruese dhe obligimet që i ka Republika e Kosovës janë një urrë lidhëse mes Kuvendit dhe Qeverisë dhe është edhe me tepër sensibilizim i opinionit ne përgjithësi sepse te gjitha institucionet e Kosovës janë te përfshira ne procesin e integritetive,por barra ju bie juve si ministre dhe koordinatorë e këtyre çështjeve , lidhur me raportin që ju e keni dorëzuar dhe te pjesa e pyetësorit që

është përgjigja ne 1500 pyetje dhe ia keni adresua Komisionit për vitin 2016-2017 ,pyes se sa janë ata te kënaqur me përgjigjet sepse sigurisht që edhe ata janë përcjellës drejtpërdrejt te implementimit te kriterëve dhe reformave ne përgjithësi. Ne aspektin politik mendoj se qeveria është duke bërë regres sa i përket integritimeve evropiane sidomos ne 2 çështjet kryesore siç janë sundimi i rendit dhe ligjit pa anashkaluar faktin edhe te pjesa e investimeve te BE-së që ndërlidhet direkt me IPA fondet dhe shembujt që ka dhënë kjo Qeveri me atë çka kërkohet dhe atë çka financohet është ne kundërshtim te plotë, sidomos pjesa qe ka te bëjë me reformën ne administratën publike ku qeveria e Kosovës pa vendim te pa bazuar ne ligj i rrit rrogat për 100% ose 200% brenda një grupi te caktuar qeveritar, andaj ju si do ta arsyetoni ndihmën financiare dhe teknike që e jep BE-ja për reformën ne administratën publike, çështja tjetër,politizimi i bordeve te pa varura ,prishja e memorandumit me Ambasadën britanike e cila është par si hap pozitiv ne qeverisjen e kaluar që një herë e përgjithmonë te hiqet dorë nga politizimi bordeve dhe agjencive te pa varura dhe besoj qe këtë arsyetim do ta paraqitni para partnerëve ndërkombëtar apo edhe para Kuvendit.

Ne vazhdim tha se koncepti dokumenti i shumë pritur që ka te bëjë me largimin e zyrtarëve që janë nën akuzë apo te dënuar,ju keni premtuar që ne emër ter Qeveris kjo do te përfundoj ne vitin e kaluar, por kjo nuk ndodhi dhe kjo do te lejë njollë te zezë sidomos ne këtë qeveri, sepse shumë njerëz te apostrofuuar edhe ne kabinetin qeveritar dhe pjesë e qeverisë duke filluar nga këshilltarët dhe stafi kanë te kaluar kriminale dhe ky është regresi dhe kjo është mos përmbushje e obligimeve dhe ideja qe ta keni një rezolutë atë duhet ta keni me konsensus brenda Qeverisë jo brenda Kuvendit te Kosovës,sepse keni deklarime te ndryshme ne raport me kryeministrin dhe te tjerët dhe janë skajshmërisht ne kundërshtim edhe me udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave por edhe për obligimet që i ka Kosova para miqve ndërkombëtar dhe këto janë publike dhe tentimi i fundit për shfuqizimin e Gjykatës speciale dhe prapë se prapë zotimi i djeshëm duket që është ikje e përgjegjësive sepse përgjegjësia është mbi 43 deputetët që kanë nënshkruar ,ajo prapë se prapë do te bie mbi përgjegjësin e tyre,ata i kanë ik përgjegjësisë personale ne aspektin e procedurave, por nuk mund te ikin përgjegjësive politike dhe dëmit që i ka bërë Republikës së Kosovës.

Konsensusi nacional dhe qoftë deklarativ dhe ne përmbushjen e kriterëve ka ekzistuar ne te kaluarën ,por kjo është prish me këtë Qeveri dhe po shihet qartë se mos përmbushja e kriterëve dhe devijimi nga kriteret tregon se ju ne Qeveri keni probleme te brendshme,ne te ardhmen nuk mund te kërkoni fonde apo Kuvendi do te jetë i kushtëzuar te kërkoj fonde kur një Qeveri fal borxhe ne kundërshtim me ligjin, ju e keni detyrë ta thoni ne mbledhje te qeverisë, dhe ju lus ta ngisni zërin aty ku jeni dhe te dilni me raport se qeveria po i përmbush obligimet dhe ne te kemi çka te deklarojmë sepse nuk mund te i mashtrojmë komisionin Evropian,andaj duhet të i kryeni detyrat ndërsa përkrahjen politike te Kuvendit e keni.

Fatmire Kollçaku, tha se e dëgjua nga ministrja që tha se gjatë vitit 2018 do te ndodh liberalizimi i vizave , e dimë se miratimi i demarkacionit është kusht i pa drejt dhe mbetet enigmatik se kush e ka futë dhe ka pas dyshime qe vet pala kosovare e ka kërkua ,koha do ta tregon këtë ,por çka mbetet me kushtin tjetër me luftimin e krimit dhe korrupsionit institucional,çka ka bërë Kosova ,sa i ka përmbush obligimet dhe a ju parashtrohet juve si kusht neper takime ne Bruksel sepse vazhdimisht po potencohet vetëm kushti i parë , por na është thënë shumë publike se ky është një ndër kushtet kryesore që duhet te përmbushet.

Sa i përket gjykatës speciale ata që fillimisht bënë presion te themelohet , tash e kanë pas një iniciativë shumë te pa sinqertë dhe shumë personale shfuqizimin e kësaj

gjykate ku do te mbesin 43 deputetët nënshkruar sepse shihet qartë se ata që i kanë shty te i japin ato nënshkrime do ti shtyjnë tani të i tërheqin dhe Kuvendi vazhdimisht është institucion nga i cili varet nga Qeveria dhe prijësit e lart politik.

Fitore Pacolli, tha, është e pa pranueshme që në intervista po minimizohet roli i kushtit kryesor, luftimi i krimit dhe korrupsionit, ne po i gënjejmë qytetarët me miratimin e demarkacionit, po edhe mos te ishte ky kusht ne nuk e kishim me pas liberalizimin e vizave ,sepse nuk keni bërë asnjë hap ne luftimin e krimit te organizuar dhe korrupsionit . u fol për vullnetin e mirë që keni ju si ministre te ecni përpara ne integrimin evropiane, ju si ministre e drejtësisë, detyra e juaj primare ka qenë reformimi i drejtësisë, ka pas obligim depolitizimin e drejtësisë dhe ju nuk e keni bërë si ministre, ka pas raste te rënda ne burg si vdekja e Astrit Deharit ne burg, nuk është marrë shumë parasysh nga ju janë anashkuar kërkesat direkte edhe te familjes por edhe shumë te tjerëve për drejtësi, e tash te presim prej juve si ministre se do te hecim përpara sa i përket integritimit evropian po me duket jo reale ,kurse për propozimin e z. Deda për formimin e grupit te përbashkët punues, tha se pajtohem, por për te punuar se bashku na duhen me tepër informata , ne raportin e punës për vitin 2017 e kemi marr dje është shumë i mangët dhe ky raport ishte dashtë te jetë i publikuar ne Web faqe, po ashtu edhe raporti per vitin 2018, do te ishte mirë që te na dërgoni se pastaj gjatë punës se përbashkët do ta kemi me te lehtë ti rendisim edhe prioritetet e komisionit.

Ne raportin e vitit 2017 i cili ka vetëm 5 faqe, thuhet se kanë për përfunduar negociatat për programin e BE-së ,Evropa për qytetarët dhe pritet që Kosova ta nënshkruaj marrëveshjen dhe te ketë qasje ne këtë program. Andaj a mundeni me na tregu se kur po pritet dhe a mundeni me na dhënë një afat, po ashtu thuhet Ministria e integritimit evropiane ka nënshkruar 5 marrëveshje ndërkombëtare, a mundeni me na tregu se me cilat shtete apo organizata ndërkombëtare janë nënshkruar këto marrëveshje. Po ashtu ne raport thuhet se jeni përgjigjur ne 1500 pyetje, do te ishte mirë që ne ti kishim këto përgjigje ne komision .

Milaim Zeka, tha se disa forca politike dhe deputet te parlamentit e përdorin te njëjtën gjuhë denigruese po sikurse politikanet e Shqipërisë ne raport me ndërkombëtarët , ne nuk e dimë ne mënyrë absolute se ne çfarë rrethanash ka vdekur Astrit Dehari , unë nuk mund ta akuzoj dhe ta quaj terrorist një njeri që ka gjuajtur gazë lotsjellës, diplomatët e nivelit lartë, politikan te BE-së na thonë se ju keni bërë akte terroriste brenda parlamentit te Kosovës dhe njerëzit janë dënuar për terrorizëm,, kurse sa i përket demarkacionit përgjegjësinë kryesore e ka Qeveria e Isa Mustafës sepse e ka zhagit demarkacionin dhe nuk e ka sjell ne parlament dhe jo Qeveria e tanishme dhe prapë ne duhet ta votojmë demarkacionin sepse bota perëndimore nuk lejon me pas hajgaregji ne Parlament.

Qeveria ka rregull, ne sa milionat i kemi harxhua neper arbitrazhe sepse dikujt ju ka tek me përktuye ligje dhe rregullore ashtu si i teket ,prandaj mbi bazën e kësaj kërkoj edhe një herë qe ne raport me ndërkombëtarët kur flasim për liberalizimin e vizave dhe çështjet e rëndësishme për vendin te jemi më kompakt e jo te shkojmë ta shajmë njeri tjetrin.

Kryetarja, lidhur me propozimin për hartimin e draft rezolutës, tha se jam pak skeptike sepse a do te kishte me prodhua diçka efikase, ne te kaluarën ne komisionin për politikë te jashtme kanë pas propozuar një rezolutë te tillë por nuk ka prodhuar ndonjë efekt, madje qysh ne draftin e parë ne kemi pas kundërshtimet tona, mendoj se ne kemi me tepër nevojë me e rikonfirmua përmbylljen e dy kritereve për liberalizimin e

vizave dhe kjo do ta qonte mesazhin sepse deri më tani për mes rezolutave nuk kemi arrit të arrijmë efikasitet .
Kemi përgjegjësi për atë çka votohet ne Kuvendin e Kosovës.

Ministrja, tha se sa i përket rezolutës,pajtohem që ne situatën ne te cilën ndodhemi tani kemi nevojë për një rikonfirmim por ne anën tjetër duhet te përcillet me një plan te bashkëveprimit me data konkrete dhe kjo ka qen edhe ideja kur e kemi propozuar rezolutën qe te kemi një vazhdim, nuk duhet te cilësohet një vizitë e ndonjë zyrtari ne Qeveri apo anëtar te Parlamentit si turizëm sepse nuk është turizëm , por duhet te ketë prezencë sa me te madhe ne BE dhe te kemi një bashkëveprim dhe koordinim.

Lidhur me rastin e Astrit Deharit tha është shumë tragjik dhe fatkeqësisht është keqpërdorur politikisht shumë dhe e dini ju shumë mirë se kush e ka keqpërdor, kanë dal deklaratat e fundit nga ju vet te si edhe nga raporti i institutit të forenzikës së Kosovës te cilët e konfirmojnë se ka qenë vetëvrasje,po ashtu edhe raporti nga instituti i forenzikës së Austrisë i cili e konfirmon se xhirimet nuk janë te manipuluar,nuk është e vërtetë që kërkesa e prindërve nuk është marr parasysh,është marr parasysh dhe e kemi përcjell ne qeveri për te përzgjedh institutin dhe kemi marr një vendim refuzues nga qeveria dhe aty është ndal procesi.

Kurse sa i përket kushtit te dytë për liberalizimin e vizave, është një kusht ne vazhdimësi te cilën ne duhet ta plotësojmë dhe ne vazhdimësi kemi rezultate ne këtë aspekt,po ta kishim kaluar demarkacionin para dy vite gjysme ne kemi pas konfirmim se kushti i vetëm i mbetur ka qenë demarkacioni dhe është demarkacioni

Asnjëherë nuk e kam thënë se viti 2018 është vit i liberalizimit te vizave, por unë po e përsërisë çdo herë se viti 2018 duhet te jetë vit i lëvizjes së lirë,nëse i përfundojmë detyrat tona te shtëpisë.

Kurse lidhur me raportin e ministrisë që u tha se është i mangët dhe ka vetëm 5 faqe, ju nëse doni mund te ju sjell 1000 faqe raport dhe qasjen e keni ne Web faqe që nëse jeni te interesuar mund ta keni dhe ta lexoni dhe te merrni informata lidhur me zbatimin e MSA-së dhe dokumente tjera qindra faqe dhe kurdo që keni kohë mund ta diskutojmë ne detaje.

Programi Evropa për qytetarët është një program që është ne negociim e sipër dhe jemi duke u munduar që te nxjerrim një pozitë sa me te favorshme për Kosovën dhe përfaqësimin sa me dinjitozë për Kosovën.

Sa i përket fondeve ,është një proces transparent që përcillet me sfidat e veta dhe këtu nuk mund te themi se Kosova është keq se jemi vendi i vetëm ne Ballkan qe për kokë banori pranojmë një shumë me te madhe te fondeve dhe vetëm për vitin 2017 kanë arritur ne 1076 mil € dhe fondet IPA mbërrijnë diku 60-70 mil€ ne vit dhe janë te ndërlydhura me reforma por jo ne mënyrë obligative. Kurse sa i përket përgjigjeve ne 1500 pyetjeve ju dërgohen komisionit evropian dhe pastaj ato pyetje mirën për bazë, mirëpo edhe ata i kanë mekanizmat e vet te cilat i marrin informatat se sa ka bërë punë Kosova,si dhe informatat i marrin nga ju gjatë vizitave dhe kontakteve që keni ,pastaj nga mediat dhe shoqëria civile, por nëse do te i kishin marr për bazë vetëm përgjigjet tona ju garantoj se Kosova shumë me shpejt do te ecte përpara .

Lidhur me koncept dokumentin për pezullimin e zyrtarëve publik tha se është miratuar ne qeveri me 15 nëntor. Kodi penal sipas afateve kohore do te miratohet ne Qeveri ne fund te marsit dhe pastaj do te procedohet ne Kuvend. Kurse sa i përket reformave ne drejtësi dhe depolitizimin e bordeve , qeveria e ka nënshkruar memorandumun me britaniket,përveç një ministrie te gjitha institucionet tjera e kanë respektuar këtë memorandum.

Lidhur me reformën e administratës publike tha se pakoja e ligjeve për reformën e administratës publike është gati, gjithashtu do të nënshkruhet edhe një memorandum dhe kryeministri ka nënshkruar letrën e konfirmimit për miratimin e 8 indikatorëve që ndërlihen me pakon e përkrahjes së BE-së dhe shumen që do të financoj në administratën publike .

Kurse lidhur me grupin e përbashkët punues tha se është ide e qëlluar që të kemi një bashkëveprim dhe koordinim shumë të afërt ,por dallimet konceptuale dhe politike që i kemi po na dëmtojnë pozitën e Kosovës , por para çdo takimi që do ta kemi në Bruksel dhe kudo qoftë, duhet të mundohemi ti afrojmë sa më tepër qëndrimet dhe ti vejme në pah të gjitha zhvillimet pozitive, kuptohet me të gjitha sfidat që i kemi.

Jam e gatshme që nga java e ardhshme të ulemi se bashku dhe ta formojmë grupin e përbashkët punues.

Kryetarja, theksoi se ka pas korrektësi nga ana e ministrisë së integritetit gjatë dërgimit të raporteve të përhershme në Komisionin tonë dhe natyrisht nëse ka specifika ,deputetët kanë të drejtë të kërkojnë pyetje shtesë .

Mbledhja përfundoi në orën 12:50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj.Blertha Deliu Kodra
